L I G J
Nr.9544, datë 29.5.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË PËR MBROJTJEN DHE ASISTENCËN E FËMIJËVE, VIKTIMA TË TRAFIKIMIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktima të trafikimit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4935, datë 16.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS GREKE PËR MBROJTJEN DHE ASISTENCËN E FËMIJËVE, VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Greke, më poshtë referuar si Palët Kontraktuese, të udhëhequr nga dëshira për të bashkëpunuar, zbatuar dhe respektuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare përkatëse, lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve,

shprehin solidaritetin dhe përkushtimin e tyre për të luftuar trafikimin e fëmijëve dhe çdo formë të shfrytëzimit të fëmijëve;

duke marrë në konsideratë, që fëmijët e pashoqëruar, në parim janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj trafikimit dhe kanë nevojë për mbrojtje dhe kujdes të veçantë;

duke kërkuar, në bazë të reciprocitetit dhe të një fryme bashkëpunimi të ndërsjellë, të merren me fenomenin e trafikimit të fëmijëve;

duke konsideruar prioritet mbrojtjen e viktimave fëmijë të trafikimit;

duke synuar, bazuar në reciprocitet dhe frymë bashkëpunimi, krijimin e kuadrit të duhur ligjor për zbatimin e procedurave dhe strukturave të posaçme për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve të trafikuar;

duke pranuar që mënyra më efektive për të parandaluar trafikimin e fëmijëve është eliminimi i shkaqeve-origjinë;

duke pranuar që interesi më i lartë i viktimës fëmijë, të trafikimit do të jetë gjithmonë një konsideratë kyçe;

duke marrë në konsideratë, konventat përkatëse të ratifikuara nga të dyja Palët Kontraktuese dhe më specifikisht, Konventën Europiane mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1950), Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës (1989), Konventën mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër Grave (1979) dhe Konventën e ILO-s mbi ndalimin dhe veprimin e

menjëhershëm për eliminimin e formave më të rënda të punës së fëmijës nr.C182 (1999);

duke marrë në konsideratë, konventat ndërkombëtare specifike të nënshkruara nga të dyja Palët Kontraktuese, të tilla si Konventa e OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (2000) dhe Protokolli mbi parandalimin, kontrollin dhe ndëshkimin e trafikimit në njerëz, veçanërisht gra dhe fëmijë, të cilat plotësohen nga Konventa e OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (2000);

duke marrë në konsideratë protokollin jo të detyrueshëm të Konventës për të drejtat e fëmijës, për shitjen e fëmjës, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijës (2000), Konventën e Hagës për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës (1980),

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

1.1 Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi, Palët bien dakord për përkufizimet e mëposhtme të termave të përdorur këtu:

Trafikimi i fëmijëve do të kuptojë rekrutimin, transportimin, transferimin, mbajtjen ose pranimin e një fëmije, përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këtë person, me qëllim shfrytëzimin e këtij fëmije. Pëlqimi indirekt ose real i fëmijës është i papranueshëm.

Trafikant do të kuptojë personin përgjegjës për trafikimin e fëmijëve. Koncepti i trafikantit do të përfshijë gjithashtu persona juridikë, në përputhje me dispozitat e nenit 4 të vendimit kuadër të Këshillit të BE-së të 19 korrikut 2002, për luftën e trafikut të qenieve njerëzore (2002/629/JHA).

Shfrytëzimi do të përfshijë shfrytëzimin e prostitucionit të fëmijëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual të fëmijëve, punët ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen apo transferimin e organeve.

Fëmijë viktimë e trafikimit do të kuptojë çdo person nën moshën 18 vjeç, kundër të cilit është kryer akti i trafikimit siç përcaktohet në këtë nen. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, një fëmijë do të konsiderohet madhor në datën kur ai/ajo mbush 18 vjeç. Në rastin kur data e saktë e lindjes nuk është e ditur, fëmija konsiderohet madhor më 31 dhjetor të vitit të ditëlindjes së tij të 18-të. Në rast se mosha e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet që personi është një fëmijë, ky person duhet të konsiderohet fëmijë dhe duhet të përfitojë nga kjo marrëveshje, derisa mosha e personit të jetë përcaktuar plotësisht.

Fëmijë-viktimë potenciale e trafikimit do t'i referohet fëmijës që ndodhet në një situatë serioze, konkrete dhe të pranishme, si rezultat i së cilës fëmija ballafaqohet me rrezikun e të kthyerit në fëmijë të trafikuar, siç përshkruhet më sipër.

Me fëmijë të pashoqëruar nënkuptojmë personin nën moshën 18 vjeç, i cili jeton në territorin e një prej Palëve Kontraktuese, i ndarë nga prindërit dhe jo nën kujdestarinë e një madhori. Fëmijët e pashoqëruar duhet të përfitojnë nga mbrojtja që ofrojnë nenet përkatëse të kësaj Marrëveshjeje në rastin e kualifikimit si fëmijë-viktimë.

Me personin që ka kujdestarinë e fëmijës nënkuptojmë prindin ose personin që përfaqëson fëmijën, falë cilësive të veçanta që i jepen nga ligjet e vendit ku ka fituar kujdestarinë.

Kujdesar i përkohshëm do të kuptojë personin përgjegjës për fëmijën deri në zbatimin e një zgjidhjeje të përhershme.

Rregulloret e emigracionit do të kuptojnë dispozitat ligjore, të cilat lejojnë lëshimin e lejeve të qëndrimit për viktimat fëmijë, të cilët qëndrojnë në qendra sociale, për të ndjekur një program social integrimi.

I.NDJEKJA PENALE

Neni 2

Harmonizim efektiv i përkufizimit të krimeve dhe procedurave. Bashkëpunim bazuar në parimet dhe metodat e pranuara nga të dyja palët

2.1 Palët Kontraktuese bien dakord që, në kuadër të sistemeve të tyre ligjore kombëtare dhe kur të kërkohet:

a) do të vendosen sanksione të veçanta për trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmjëve,

b) do të penalizohet tentativa, bashkëpunimi dhe nxitja morale, lidhur me krimin e trafikimit të fëmijëve,

c) do të institucionalizohet përgjegjësia ligjore e personave juridikë të përfshirë në trafikimin e fëmijëve,

d) do të hyjnë në fuqi dispozita që përligjin ndalimin, konfiskimin dhe masat administrative kundër trafikantëve,

e) do të miratohen dispozita që paracaktojnë konfiskimin e të gjitha objekteve në pronësi të trafikantëve, të cilat ishin përdorur për trafikim, pavarësisht nga fakti që trafikantët janë pronarët e tyre,

f) do të hartohen ligje, të cilat ndalojnë shfaqjen e neglizhencave të rënda nga ana e personit, i cili ka kujdestarinë e fëmijës, apo dhënien e fëmijës një personi tjetër në shkëmbim të parave ose për qëllime përfitimi, dhe do të merren masa kundër punëdhënësve që punësojnë fëmijë-viktima,

g) legjislacioni për mbrojtjen e dëshmitarëve fëmijë do të harmonizohet në përputhje me standardet ndërkombëtare.

2.2 Palët Kontraktuese bien dakord të miratojnë rregullore të emigracionit në lidhje me lëshimin e lejeve të qëndrimit për fëmijët-viktima në përputhje me nenin 9.4.

Neni 3

Veprim dhe bashkëpunim ndërmjet autoriteteve policore

3.1 Palët Kontraktuese marrin përsipër të miratojnë masa efektive, nëse këto masa nuk ekzistojnë, për themelimin ose funksionimin e njësive antitrafik në strukturën e autoriteve të përshtatshme policore, të përbëra nga personel i trajnuar, që punon me kohë të plotë, për mbrojtjen e fëmijëve.

3.2 Pas marrjes në konsideratë të marrëveshjeve dypalëshe përkatëse për bashkëpunimin policor ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe më specifikisht, marrëveshjes së bashkëpunimit të Ministrive të Rendit Publik për çështje të kompetencave të tyre, të datës 17 korrik 1992, është rënë dakord që ky bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni do të azhurnohet me qëllim luftën ndaj trafikimit të fëmijëve, falë miratimit të protokolleve shtesë për zbatimin e Marrëveshjes. Protokolle të tilla shtesë mund të përfshijnë:

a) hartimin e standardeve të përbashkëta për mbledhjen e rregullt dhe efiçente të informacionit, si dhe shkëmbimet statistikore lidhur me trafikimin e fëmijëve dhe e të gjitha formave të shfrytëzimit, përsa i përket personit që kryen trafikimin, metodave dhe rrugëve të përdorura,

b) krijimin e bazave të dhënave të referencës në pikat e kalimit të kufirit, sipas dispozitave të garantimit të sigurisë së plotë të të dhënave personale që do të futen në bazën e të dhënave,

c) vendosjen e vlerësimeve dypalëshe në lidhje me përshtatshmërinë e masave të kontrollit të kufirit lidhur me fëmijët,

d) trajnimin dhe koordinimin e procedurave të përbashkëta që do të aplikohen në kalimet kufitare, duke synuar përmirësimin e aftësive të personelit të kontrollit të kufirit për të identifikuar fëmijët-viktima të mundshëm dhe trafikuesit, si dhe rregullimin e procedurave të trajtimit fillestar të fëmijëve nga personeli i kontrollit të kufirit,

e) forcimi i kontrolleve të kufirit, deri në masën e nevojshme që kërkon parandalimi i trafikimit të fëmijëve, subjekt i angazhimeve ndërkombëtare në lidhje me lëvizjen e lirë të njerëzve,

f) miratimi i masave të kontrollit të kufirit, të tilla si ndalimi i hyrjes, revokimi i vizës dhe burgimi i përkohshëm i mundshëm, për persona të përfshirë në trafikimin e fëmijëve,

g) miratimi i rregulloreve për të cilat është rënë dakord nga të dyja palët lidhur me riatdhesimin në kufi dhe procedurat vepruese, në përputhje me nenin 11,

h) trajnime të mundshme të oficerëve të kontrollit të kufirit, oficerëve të policisë, prokurorëve, gjykatësve, oficerëve të emigracionit dhe të gjithë zyrtarëve kompetentë në të gjitha çështjet e trafikimit të fëmijëve, përfshirë identifikimin,

i) monitorimi i asistencës së dhënë fëmijëve-viktima pas riatdhesimit të tyre, përfshirë kushtet e tyre të jetesës dhe kushtet e ribashkimit të fëmijëve me familjet e tyre.

3.3 Palët Kontraktuese bien dakord të përdorin kanale komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve policore dhe ambasadave e konsullatave respektive, me qëllim garantimin e shpejtë të vlefshmërisë dhe të ligjshmërisë së dokumenteve të udhëtimit, provës së identitetit dhe të të

dhënave personale, kur ka dyshime të arsyeshme rreth përdorimit të këtyre dokumenteve në trafikimin e fëmijëve.

3.4 Për zbatimin e duhur të këtij neni, të dyja Palët Kontraktuese do të krijojnë pika të posaçme kontakti brenda autoriteteve të tyre policore.

II. PARANDALIMI

Neni 4
Politikat financiare dhe sociale në trajtimin e shkaqeve të origjinës së trafikimit të fëmijëve

4.1 Palët Kontraktuese bien dakord të zbatojnë politika efektive ekonomike dhe sociale në lidhje me grupet më të ndjeshme, duke synuar eliminimin e varfërisë dhe krijimin e mundësive reale, të cilat do të parandalojnë shkaqet themelore të trafikimit të fëmijëve që në origjinën e tyre. Të tilla politika do të synojnë:

a) përmirësimin e aksesit të fëmijëve në mundësitë për arsimim dhe trajnim profesional,

b) rritjen e përqindjes së ndjekjes së shkollës dhe trajnimit profesional, veçanërisht për vajzat dhe fëmijët e huaj,

c) trajtimi i problemit të punës së pambrojtur, informale dhe jo të ligjshme të fëmijëve.

4.2 Palët Kontraktuese marrin përsipër të informojnë njëra-tjetrën për masat e veçanta që merren dhe zbatohen duke synuar grupet shoqërore të mësipërme.

4.3 Palët Kontraktuese do të ekzaminojnë rregullisht efektivitetin e aplikimit të këtyre masave dhe do të bien dakord për të proceduar për përmirësimin e tyre të mëtejshëm.

Neni 5
Rritja e ndërgjegjësimit

5.1 Palët Kontraktuese bien dakord që, me qëllim parandalimin në mënyrë efektive të trafikimit të fëmijëve (në rast se mungojnë të tilla masa parandaluese), është e nevojshme që shoqëria në përgjithësi dhe grupet e synuara në veçanti, të ndërgjegjësohen për trafikimin e fëmijëve. Në këtë kuadër, Palët Kontraktuese marrin përsipër:

a) të ndërmarrin një fushatë informative për ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me trafikimin e fëmijëve dhe për format e ndryshme të manifestimit të tij në Palët Kontraktuese, në bashkëpunim me shoqërinë civile, organizatat joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare të përfshira në aktivitete për mbrojtjen e fëmijëve dhe me aktorë joshtetërorë. Secila Palë Kontraktuese do të marrë përsipër koston e fushatës informative në territorin e vet;

b) të ndërgjegjësojnë grupe të tjera kompetente, si hartuesit e politikave, personelin e policisë dhe profesionistë të tjerë kompetentë, si p.sh. shërbimet mjekësore dhe sociale, shërbimet e punësimit dhe sektori publik për trafikimin e fëmijëve në mënyrë që të rritet gatishmëria e tyre për të trajtuar siç duhet trafikimin e fëmijëve dhe për të forcuar potencialin e tyre institucional me qëllim luftën kundër trafikimit të fëmijëve;

c) të ndërgjegjësojnë publikun për arsimin e detyruar, për sanksionet ndaj personave që kanë kujdestarinë e fëmijës dhe nuk e çojnë këtë fëmijë në shkollë, si dhe për ndalimin e punës së fëmijëve;

d) të trajtojnë nevojën për të reduktuar kërkesën për aktivitete që kanë lidhje me fëmijë të trafikuar, si p.sh. lypja, shfrytëzimi seksual, puna e detyruar, skllavëria ose praktika të ngjashme dhe të promovojnë parimin e tolerancës zero për të gjitha format e trafikimit të fëmijëve;

e) të krijojnë dhe të reklamojnë në mënyrë efektive linja telefonike emergjente, nëpërmjet të cilave fëmijëve-viktima t'u afrohet këshillim dhe udhëzime, dhe të cilat do të lehtësojnë kallëzimet anonime për trafikimin e fëmijëve.

Neni 6
Masat institucionale për parandalimin e trafikimit të fëmijëve

6.1 Palët Kontraktuese marrin përsipër të vënë në jetë masat institucionale të mëposhtme për parandalimin më efektiv të trafikimit të fëmijëve, në varësi të nevojave:

a) krijimin e një grupi qendror koordinues, me qëllim përmirësimin e efektivitetit të grupeve institucionale publike. Për palën shqiptare, ky organ do të jetë Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore i drejtuar nga Ministri i Brendshëm. Për palën greke ky grup do të jetë Komiteti i Përhershëm Ndërministror me dekret presidencial 233/2003, neni 9;

b) sigurimin e burimeve njerëzore dhe financiare për të luftuar trafikimin e fëmijëve si një problem shoqëror dhe financiar;

c) sigurimin e asistencës për zhvillimin e një rrjeti të përshtatshëm shërbimesh sociale, funksioni i të cilit do të jetë, mes të tjerash, marrja me fenomenin e trafikimit të fëmijëve ndihmuar nga shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe aktorët joshtetërorë;

d) sigurimi i regjistrimit të të gjitha lindjeve, pavarësisht nga vendi i lindjes.

III. MBROJTJA

Neni 7
Parime të përgjithshme të mbrojtjes së fëmijëve-viktima

7.1 Palët Kontraktuese bien dakord që të gjitha veprimet e ndërmarra në lidhje me fëmijët-viktima duhet të udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës, parimi i mosdiskriminimit, respekti për mendimet e fëmijës, si edhe për të drejtat e tij apo të saj për informacion, privatësi, konfidencialitet dhe për mbrojtje.

7.2 Institucionet shtetërore përkatëse të të dyja Palëve Kontraktuese do të bashkëpunojnë për vënien në jetë të kësaj Marrëveshjeje. Për të siguruar vënien efektive në jetë të kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm dhe për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e fëmijës, Palët Kontraktuese do të krijojnë një strukturë të posaçme shtetërore, këtu e më pas referuar si “Autoriteti Përgjegjës”. Për palën shqiptare, ky autoritet do të jetë Komisioni i Përbashkët për Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit. Për palën greke, ky autoritet do të jetë Qendra Kombëtare e Solidaritetit Social për Emergjencat e Sekretariatit të Përgjithshëm të Mirëqenies së Ministrisë së Shëndetësisë, Mirëqenies dhe Mbrojtjes Sociale.

7.3 Autoriteti Përgjegjës do të sigurojë bashkëpunimin ndërmjet organeve përkatëse institucionale në përputhje me standardet e kujdesit për fëmijët dhe do të respektojë dhe garantojë parimet e përgjithshme të mbrojtes së viktimës fëmijë, siç parashikohet në instrumentet përkatëse ndërkombëtare.

Neni 8
Identifikimi i viktimave fëmijë

8.1 Palët Kontraktuese do të miratojnë procedura efektive për identifikimin e menjëhershëm të viktimave fëmijë në territorin e tyre. Policia, shërbimet sociale, shërbimet e kujdesit mjekësor, institucionet arsimore, autoritetet lokale, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare menjëherë, sapo të vihen në dijeni të pranisë së një viktime-fëmijë potenciale në territorin e Palëve Kontraktuese, do të njoftojnë menjëherë Autoritetin Përgjegjës të vendit të tyre, i cili do të koordinojë veprimet me strukturat kompetente dhe shërbimet sociale.

8.2 Kur fëmija identifikohet, Autoriteti Përgjegjës do ta regjistrojë fëmijën në një regjistër të veçantë dhe do të hapë një dosje personale për fëmijën.

Neni 9
Referimi i një viktime fëmijë, te autoritetet kompetente

9.1 Autoritetet Përgjegjëse, në bashkëpunim me prokurorin publik për fëmijët, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare të përfshira në aktivitete për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe aktorë të tjerë joshtetërorë, do të kërkojnë në mënyrë aktive identifikimin e viktimës fëmijë dhe, në bashkëpunim me shërbimin e policisë përkatëse, do të organizojnë transferimin sa më të shpejtë të fëmijës në një qendër të kujdesit. Qendrat e kujdesit duhet të jenë të mbrojtura, të sigurta dhe të përshtatshme për moshën dhe nevojat e fëmijës. Në çdo rast, palët garantojnë që qendrat do t’i ofrojnë fëmijës mbrojtje, ushqim, aktivitete zbavitëse. Për këtë qëllim, grupi qendror koordinues dhe Autoriteti Përgjegjës i secilës Palë Kontraktuese mund të përfundojnë marrëveshje, direktiva dhe

memorandume mirëkuptimi me organizata ndërkombëtare dhe joqeveritare të përfshira në aktivitete për mbrojtjen e fëmijëve, si edhe me aktorë joshtetërorë me qëllimin e sigurimit të shërbimeve sociale dhe të qendrave të kujdesit.

9.3 Fëmijët e sëmurë, të paaftë dhe fëmijët me probleme psikologjike, të miturat shtatzëna etj., do të marrin kujdes të veçantë në varësi të nevojave të tyre. Palët do të përdorin personel të aftë të komunikojë me fëmijën në gjuhën e kuptueshme prej fëmijës.

9.4 Çdo fëmijë i vendosur në një qendër të kujdesit do të marrë ose një leje qëndrimi si viktimë e trafikimit të fëmijëve, nëse autoriteti kompetent ka lëshuar një akt karakterizimi si të tillë, ose lejeqëndrimi për arsye humanitare, sipas rastit, në bazë të parashikimeve ligjore të vendit. Kujdestari i caktuar i fëmijës është përgjegjës për aplikimin e lëshimit të lejes nga autoritetet shtetërore përkatëse. Leja e qëndrimit do të jetë në forcë derisa fëmija vjen nën një status tjetër ligjor për shkak të vënies në zbatim të një zgjidhjeje të përhershme.

Neni 10

Caktimi i një kujdestari të përkohshëm

10.1 Pas transferimit të fëmijës në qendrën e kujdesit, Autoriteti Përgjegjës është i detyruar të kërkojë që fëmija të vendoset nën kujdestari, në përputhje me legjislacionin përkatës të vendit. Kujdestari i përkohshëm do të shoqërojë fëmijën dhe do të mbrojë interesat e fëmijës deri në gjetjen e një zgjidhjeje të përhershme, ashtu siç parashikohet në nenin 12-16. Kujdestaria mund t'i besohet Autoritetit Përgjegjës, qendrës së kujdesit ku është vendosur fëmija dhe/ose organizatave e institucioneve që njihen për kujdesin e fëmijëve. Numri i fëmijëve të vendosur në kujdestari duhet të jetë brenda kufijve mbikëqyrës të njësisë së cilës i caktohet kujdestaria. Personat, të cilëve do t'u besohet kujdestaria e fëmijës, duhet të jenë të trajnuar dhe me eksperiencë në çështjet e kujdesit për fëmijët dhe për viktimat fëmijë. Përveç kësaj, ata duhet të jenë në gjendje të komunikojnë në një gjuhë të kuptueshme për fëmijën. Në rast se kujdestaria nuk i është besuar Autoritetit Përgjegjës, ky Autoritet do të nxjerrë rregulla dhe do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme ushtrimin e kujdestarisë.

10.2 Në përputhje me legjislacionin e Palëve Kontraktuese, kujdestari i përkohshëm do të ketë ndër të tjera, detyrat e mëposhtme:

a) Ai/ajo do të garantojë që të gjitha veprimet do të mbrojnë interesat e fëmijës.

b) Ai/ajo do të informojë vazhdimisht fëmijën për procedurat, lidhur me gjendjen aktuale të fëmijës dhe mundësitë për të ardhmen, në mënyrë që të vlerësohen rreziqet e sigurisë për të marrë një vendim të vlefshëm lidhur me të ardhmen e fëmijës.

c) Ai/ajo do të asistojë në procesin e gjetjes së familjes së fëmijës ose personit që ka kujdestarinë e fëmijës në vendin e origjinës.

d) Ai/ajo do të punojë si një ndërlidhës mes fëmijës dhe organizatave dhe shërbimeve të përfshira në proces dhe të ngarkuara për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës.

e) Ai/ajo do të garantojë, në rast riatdhesimi, përgatitjen e duhur të kthimit të fëmijës, përgatitjen e familjes dhe të fëmijës, kthimin e sigurt dhe respektimin e interesave të fëmijës.

f) Ai/ajo do të garantojë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të kujdestarisë. Në këtë kuadër, kujdestari i përkohshëm ka të drejtën e përjashtimit nga detyrimi për të dëshmuar në gjykatë, nëse kështu është në të mirën e fëmijës.

Neni 11

Vlerësimi i individualizuar i rasteve

11.1 Rastet e trafikimit të fëmijëve do të hetohen nga shërbimet policore kompetente të Ministrisë së Brendshme për Republikën e Shqipërisë dhe Ministrisë së Rendit Publik të Republikës Greke, siç parashikohet në nenin 3.1 këtu. Gjatë hetimit, fëmija do të pyetet vetëm kur është e domosdoshme dhe do të bëhen përpjekje që intervista të tilla të minimizohen. Intervista do të bëhet vetëm me lejen e marrë paraprakisht nga personi që ka kujdestarinë e fëmijës, person i cili duhet të jetë i pranishëm gjatë intervistës dhe mund ta ndërpresë atë kur ai mendon se intervista dëmton mirëqenien e fëmijës. Intervistuesi duhet të përpiqet të shmangë ushtrimin e presionit psikologjik dhe shkaktimin e traumave psikologjike te fëmija gjatë intervistës.

Neni 12

Gjetja e një zgjidhjeje të përhershme

12.1 Palët Kontraktuese duhet të përdorin masën e riatdhesimit të sigurt të fëmijës në rast se kjo kërkohet. Autoritetet Përgjegjëse të të dy vendeve do të studiojnë në bashkëpunim të ngushtë, çdo rast të trafikimit të fëmijëve dhe do të vendosin për një zgjidhje të përhershme që do të garantojë interesat e fëmijës.

12.2 Autoriteti Përgjegjës, duke konsideruar riintegrimin në familje si prioritet dhe bazuar vetëm në interesin më të lartë të fëmijës, mund të vendosin si zgjidhje të përhershme riatdhesimin e sigurt, integrimin e fëmijës në vendin pritës ose transferimin e fëmijës në një vend të tretë.

12.3 Në marrjen e këtij vendimi Autoritetet Përgjegjëse do të konsultojnë fëmijën dhe do të marrin parasysh vullnetin e fëmijës në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës.

12.4 Në vendimmarrjen e tyre, Autoritetet Përgjegjëse të Palëve Kontraktuese do të marrin në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit dhe në veçanti rezultatet e vlerësimit të rrezikut, të kryer nën përgjegjësinë e përbashkët të Palëve Kontraktuese.

Neni 13

Vënia në zbatim e zgjidhjes së përhershme

13.1 Autoritetet Përgjegjëse të Palëve Kontraktuese do të përpunojnë procedura të përbashkëta për realizimin e një shkëmbimi të shpejtë informacioni lidhur me rastet e trafikimit të fëmijëve, të cilat do të përfshijnë procedura për pjesëmarrjen e ministrive përkatëse, ambasadave dhe/ose konsullatave.

13.2 Nëse nuk zgjidhet opsioni i bashkimit familjar dhe/ose riatdhesimi i fëmijës, kujdestari i përkohshëm do të mbetet përgjegjës për viktimën fëmijë, deri në caktimin e një përfaqësuesi ligjor/kujdestar i fëmijës nga gjykata.

Neni 14

Riatdhesimi i sigurt

14.1 Kthimi i fëmijës do të kryhet nëpërmjet një procedure vullnetare, legjitime, të asistuar, të mirëpërgatitur, të sigurt në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës. Procedurat për transportin e fëmijës do të përshkruhen në një protokoll shtesë të kësaj Marrëveshjeje. Gjatë riatdhesimit të sigurt të fëmijës, Autoritetet Përgjegjëse mund të bashkëpunojnë me organizata ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare të përfshira në aktivitete të mbrojtjes së fëmijës.

14.2 Autoriteti Përgjegjës i vendit të origjinës do të përpunojë dhe vërë në jetë projekte të posaçme me qëllim riintegrimin e fëmijës në vendin e origjinës. Projekte të tilla do të mbulojnë mbrojtjen, mbështetjen psikologjike dhe mjekësore, riintegrimin në sistemin arsimor, dhënien e këshillimit ligjor dhe përfaqësimin, si dhe çdo formë tjetër të ndihmës siç e kërkon legjislacioni mbi mbrojtjen e fëmijëve në vendin e origjinës. Për këtë qëllim, ato do të bashkëveprojnë ngushtësisht me organizatat ndërkombëtare, institucionet joshtetërore dhe organizatat joqeveritare.

14.3 Autoriteti Përgjegjës i vendit të origjinës do të vlerësojë mirëqenien e viktimës fëmijë dhe do të monitorojë jetën e saj/e tij pas bashkimit me familjen dhe pas vendosjes së fëmijës në një kujdes alternativ në vendin e origjinës dhe do të paraqesë një raport dyvjetor tek Autoriteti Përgjegjës i vendit pritës, derisa fëmija të mbushë 18 vjeç. Autoriteti Përgjegjës i vendit pritës në bashkëpunim me organizatat joqeveritare të përfshira në aktivitete të mbrojtjes së fëmijëve dhe me aktorët joshtetërorë, mund të vlerësojnë situatën nëpërmjet vizitave në vend, pas njoftimit të Autoritetit Përgjegjës të vendit të origjinës. Në rastin kur është përcaktuar me siguri se kushtet e jetesës së viktimës fëmijë mbartin rrezikun e rishfrytëzimit, do të hartohet një raport dhe të dyja palët do të konsultohen në mënyrë që ta zgjidhin menjëherë çështjen.

14.4 Në rastin, kur fëmija ndesh probleme me prindin/prindërit apo kujdestarin pas kthimit të saj/të tij, Autoriteti Përgjegjës i vendit të origjinës:

a) do të mbrojë interesat e fëmijës derisa fëmija të mbushë 18 vjeç, të drejtat e fëmijës dhe shërbimet e ndryshme në dispozicion të fëmijës, në përputhje me të drejtën për informim;

b) do të sigurojë që fëmija të marrë kujdesin e nevojshëm që do të përfshijë, në çdo rast

akomodimin, ushqimin, mbështetjen psikologjike dhe mjekësore, si dhe arsimimin në një gjuhë të kuptueshme nga fëmija. Ky kujdes nuk duhet të jetë më i ulët se ai që Palët Kontraktuese u japin fëmijëve të nacionalitetit të tyre, në përputhje kjo me parimin e mosdiskriminimit;

c) do të ndjekë intervistat e fëmijës me autoritetet policore dhe do të garantojë që intervistat të bëhen në përputhje me principet e përgjithshme të vendosura nga kjo Marrëveshje, si edhe nga ligji i vendit dhe ai ndërkombëtar;

d) do t'i garantojë fëmijës mundësinë për një mbështetje dhe përfaqësim ligjor të përshtatshëm, në përputhje me interesat më të larta të fëmijës;

e) do të konsultohet me fëmijën dhe do të marrë në konsideratë mendimet e tij, në varësi të moshës dhe shkallës së pjekurisë, dhe në përputhje me parimin e respektimit të perspektivës së fëmijës;

f) do të luajë një rol aktiv në gjetjen e zgjidhjeve më të mira të mundshme që do të garantojnë interesat e fëmijës.

Neni 15
Integrimi

15.1 Në rast se vendoset që fëmija do të integrohet në vendin pritës, Autoriteti Përgjegjës do të përpiqet të garantojë integrimin e plotë të fëmijës në vendin pritës. Në këtë kuadër, integrimi i fëmijës në familje ose ambient komunitar është më i preferueshëm se vendosja në institucione.

15.2 Një fëmijë, i cili është subjekt i legjislacionit për kujdestarinë, mund të birësohet. Në rast se fëmija ka probleme me kujdestarin/familjen kujdestare, Autoritei Përgjegjës do të mbrojë interesat e fëmijës deri në moshën 18 vjeç.

15.3 Palët Kontraktuese bien dakord të miratojnë, kur është e nevojshme, legjislacionin që do të dënojë organizimin e birësimit të fëmijëve në shkelje me legjislacionin e vendit për birësimin, me sanksione që zbatohen për trafikimin e fëmijëve.

15.4 Palët Kontraktuese bien dakord të miratojnë, kur është e nevojshme, legjislacionin që do të dënojë organizimin e birësimit të fëmijëve në shkelje me legjislacionin e vendit për birësimin, me sanksione që zbatohen për trafikimin e fëmijëve.

Neni 16
Rivendosja e fëmijës në një vend të tretë

16.1 Autoriteti Përgjegjës i vendit pritës mund të vendosë transferimin e fëmijës në një vend të tretë, në rast se në këtë vend sigurohet kujdestaria ligjore dhe një program integrimi, në përputhje me interesat më të larta të fëmijës, të drejtën e fëmijës për informim dhe duke marrë parasysh mendimin e saj/e tij për vendosjen në një vend të tretë.

16.2 Autoriteti Përgjegjës i vendit pritës do të organizojë shoqërimin e fëmijës deri te pika hyrëse e vendit të tretë, në përputhje me rregullat e transportit të protokollit shtesë të kësaj Marrëveshjeje.

16.3 Autoriteti Përgjegjës i vendit pritës do të monitorojë vendosjen dhe integrimin e fëmijës në vendin e tretë dhe do të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse për përgatitjen e raporteve vjetore mbi rastin, derisa fëmija të mbushë 18 vjeç.

Neni 17

17.1 Palët Kontraktuese marrin përsipër vënien në zbatim të kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet takimeve të përbashkëta vjetore të autoriteteve të përfshira. Organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare, dhe aktorët e tjerë joshtetërorë të përfshira në aktivitete për mbrojtjen e fëmijëve mund të ftohen nga Palët Kontraktuese në këto mbledhje. Për mbledhjet (datat, rendin e ditës etj.) Palët Kontraktuese do të bien dakord nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 18

18.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të dalë në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj

Marrëveshjeje do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet konsultimeve dhe/ose negociatave.

Neni 19

Rishikimi dhe/ose ndryshimi i kësaj Marrëveshjeje

19.1 Kjo Marrëveshje mund të rishikohet ose të ndryshohet në çdo kohë me aprovim dypalësh me shkrim. Të tilla rishikime apo ndryshime do të hyjnë në fuqi, në datën e caktuar nga palët, dhe do të jenë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 20

Dispozita finale

20.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë pas njoftimit të dytë me shkrim nga Palët Kontraktuese, në të cilën ato do të shpallin përfundimin e procedurave përkatëse ligjore ndërkombëtare.

20.2 Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për një kohë të pacaktuar.

20.3 Palët Kontraktuese mund ta denoncojnë këtë Marrëveshje nëpërmjet njoftimit me shkrim përmes kanaleve diplomatike. Denoncimi do të jetë efektiv një muaj pas ditës së marrjes së njoftimit.

Nënshkruar në Tiranë, më 27 shkurt 2006, në dy kopje origjinale, në shqip, greqisht dhe anglisht, të gjitha tekstet njëlloj të njëjta. Në rast ndryshimi në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, do të merret për bazë teksti anglisht.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë Iva Zajmi	Për Qeverinë e Republikës Greke Evripidis Styliandis